



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:163429

Datë: 13.01.2020

Numri i dokumentit: 00756930

**P.nr. 234/17**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari Avni Sylja, me Bashkëpunëtoren Profesionale Bleta Gashi Rrusta, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në çështjen penale kundër të pandehurve L.N. dhe E.R. nga P...., të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP/II.nr.6194/15, të datës 16.01.2017, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jashtë seancës e me datë 13.01.2020, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**H U D H E T** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP/II.nr.6194/15, të datës 16.01.2017, sa i përket veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurve L.N. i biri i .... dhe nënës .... e gjinisë ..., i lindur me ... në P...., me vendbanim në rrugën “...” me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së ....., dhe E.R., i biri ..... dhe nënës ... e gjinisë ..., me vendbanim në rrugën “.....” me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së ....., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jashtë seancës me datë 13.01.2020, pasi që ka arritur **parashkrimi absolut** i ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurve L.N. dhe E.R. për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP/II.nr.6194/15, të datës 16.01.2017.

Gjykata Themelore në Prishtinë pas pranimit të kësaj lënde dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të saj, ndaj të pandehurve L.N. dhe E.R., për veprën penale Vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me datë 09.07.2018 ka caktuar seancë të shqyrtimit fillestar, mirëpo të njëjtit nuk kanë prezantuar dhe gjykata nuk ka pasur dëshmi që të njëjtit janë ftuar në mënyrë të rregullt dhe në fletë dorëzim është cekur se në adresën e dhënë pala është e panjohur, andaj gjykata me datë 30.07.2018 Policisë së Kosovës – Stacioni Policor Veriu i ka lëshuar

urdhëresë për verifikim adrese dhe dorëzim ftese për të pandehurit L.N. dhe E.R. ku Stacioni Policor Qendra ka bërë njoftim se duke vepruar në bazë të urdhëresës për verifikim adrese, kanë kontaktuar me babain e E. – H.R. i cili i ka njoftuar se biri i tij E. gjendet në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan dhe adresa e tyre është “.....” nr.... që i takon zonës së përgjegjësisë së Stacionit Veriu ka mbikëqyrë masën e arrestit shtëpiak deri sa i pandehuri ka qenë nën atë masë. Andaj gjyqtari i çështjes duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se ndaj të pandehurve L.N. dhe E.R. për veprën penale Vjedhja nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ka arritur afati kohor i ndalesës absolute të ndjekjes penale, ngase sipas dispozitave të nenit 106 par.1 pika 1.6 të KPRK-së, vepra penale e cila është e dënueshme deri në një (1) vit burgim parashkruhet kur të kanë kaluar 2 vite nga data e kryerjes së veprës penale kurse sipas dispozitave të nenit 107 par. 8 të KPK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, ndërsa në rastin konkret kanë kaluar më shumë se 4 vite nga koha e kryerjes së veprës penale, ngase vepra penale është kryer me datë **30.09.2015** ndërsa ndalesa absolute e ndjekjes penale është arritur me datë **30.09.2019**.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit është marrë në bazë të nenit 454 par.4 të KPPK-së.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 par.1 dhe 3 të KPPK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit të lartcekur të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në pajtim me nenin 106 par.1 pika 1.6 dhe nenit 107 par 8 të KPK-së, si dhe nenin 253 par.1 nën par. 1.3 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**- Departamenti i Përgjithshëm -Penal**  
**P.nr.234/17, datë 13.01.2020**

**Bashkëpuntorja Profesionale**  
Bleta Gashi Rrusta

**Gjyqtari**  
Avni Sylja

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.